

L I G J
Nr.8243, datë 17.9.1997

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7524, DATË 19.11.1991 "PËR STATUSIN E
RADIOTELEVISIONIT SHQIPTAR"**

Në mbështetje të nenit 16 e 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një grupi deputetësh

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Në nenin 5 të ligjit nr.7524, datë 19.11.1991 "Për statusin e Radiotelevizionit Shqiptar" shtohen paragrafët e mëposhtëm me këtë përmbajtje:

"Radio-Televizioni Shqiptar garanton me rregullore të veçantë kushte të barabarta për t'u shprehur midis pozitës dhe opozitës, duke respektuar edhe shpërndarjen proporcionale kohore, në bazë të përqindjes së votave të fituara në zgjedhjet e fundit parlamentare, por edhe duke garantuar një kuotë minimalisht të domosdoshme për partitë e vogla parlamentare dhe jo parlamentare.

Në edicionet informative në Radio-Televizionin Shqiptar të jepen rregullisht lajme të shkurtra për rendin e ditës të seancave dhe debateve në Kuvendin Popullor dhe për vendimet përkatëse, lajme për organizma shtetërorë e shoqërorë, fetarë, artistiko-kulturorë, shkencorë, sportivë, sindikalistë etj., lajme për pozitën e opozitën, për aq sa lejon profesionalisht nocioni lajm, si dhe për të njëjtën temë të jepen opinione alternative.

Ngarkohet Komisioni i Përhershëm i Kuvendit Popullor i Mjeteve të Informimit Publik për ndjekjen e respektimit të detyrimeve që rrjedhin nga dy paragrafët e mësipërm."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.